



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 685 Prot.

Tiranë, më 22 . 02 . 2023

Lënda: Kërkesë për ndryshim të Rendit të Ditës të Seancës Plenare dt 23.02.2023, ora 10.00

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA

KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Zonja Kryetare,

Prej më shumë se një muaj, i gjithë opinionimi publik shqiptar e ndërkombëtar është njohur me një skandal të përmasave ndërkombëtare që ka përfshirë Kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama. Prej akt-akuzave të ngritura nga drejtësia amerikane, McGonigal akuzohet që ka shkelur sanksionet amerikane ndaj oligarkut rus Oleg Deripaska i cili rezulton me lidhje të forta me Presidentin rus Vladimir Putin, por që gjithashtu figuron me biznese të licensuara drejtpërdrejt nga Qeveria shqiptare. Në njëërën prej akt-akuzave të drejtësisë amerikane, emri i Kryeministrit Edi Rama, përmendet 14 herë. Nga kjo akt-akuzë rezulton që Kryeministri Edi Rama është përfshirë në akte të rënda korruptive nëpërmjet takimeve sekrete të paautorizuara me McGonigal apo dhënies së rryshfetit prej të paktën 225 mijë dollarëve me qëllim përdorimin e organeve ligjzbatuese përkatëse për të ndikuar në zhvillimet e brendshme politike në Shqipëri. Sipas pikës 25 të akt-akuzës rezulton që “pas udhëtimit në Shqipëri në muajin shtator (2017), McGonigal ruajti marrëdhënie të vazhdueshme me Kryeministrin e Shqipërisë”.

Ky skandal është pasqyruar gjerësisht në të gjitha mediat prestigjioze ndërkombëtare si CNN, Washington Post, Fox News, New York Times, New York Post, Business Insider, Daily Mail, MCNBC, mediat kryesore franceze, italiane, si dhe Newsletter e mbrojtjes së SHBA etj, të cilat i kanë kushtuar hapësirë qëndrore apo Breaking News.

Një skandal i përmasave të paprecedent ku Kryeministri i Shqipërisë ndërhyr nëpërmjet korrupsionit në funksionimin ligjor të organeve të një shteti partner strategjik e aleat, me qëllim përdorimin e tyre në luftën e brendshme politike në Shqipëri, ka pasoja të rënda mbi reputacionin e qeverisë shqiptare dhe marrëdhëniet ndërshtetërore.

Deputetët e opozitës kanë kërkuar në mënyrë të përsëritur të përdorin instrumentat që Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit përcakton duke i dhënë hapësirë funksionit kontrollues të Parlamentit. Asnjë instrument nuk zëvendëson tjetrin ashtu siç po kërkohet që bëhet nga ana e Maxhorancës Socialiste. Rregullorja ka përcaktuar kërkesat për Interpelanca, Interpelanca Urgjente, Mocione me debat, Seanca të përjavshme (të detyrueshme) pyetjesh me Kryeministrin dhe Ministrat, etj. Asnjëra nuk zëvendëson tjetrën.

Në mënyrë të qëllimshme, ju zonja Kryetare, në shkelje të Nenit 76/1 të Kushtetutës, Nenit 7/1 e Rregullores së Kuvendit, po pengoni funksionin kontrollues të opozitës në parlament duke refuzuar në mënyrë të qëllimshme të gjitha kërkesat e bëra zyrtarisht nga ana e deputetëve të opozitës.

Bazuar në Nenin 31 pika 2 dhe Nenin 98 të Rregullores së Kuvendit, një grup deputetësh të opozitës kërkojnë:

1. Ndryshimin e Rendit të Ditës;
2. Në përputhje me pikën 1, përfshirjen si pikë e parë e Rendit të Ditës të një Mocioni me Debat për çështjen e mësipërme;
3. Debati të jetë me kohë të pakufizuar, ku çdo deputet të ketë një kohë minimalisht prej 10 minutash për të diskutuar.

Kryetarja e Kuvendit të mbledhë menjëherë pas dorëzimit të kësaj kërkesë, Konferencën e Kryetarëve, para fillimit të Seancës Plenare datë 23 shkurt 2023, ora 10.00, për të bërë ndryshimin e Rendit të Ditës të kësaj seance sipas kërkesës së mësipërme.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DEPUTETËT:

Firmat për kërkesën e ndryshimit të rendit të ditës 23.02.2023

Lugini Baci

Karem Mahmutaj

Alben Vashi
Luf Celuf

Kostriot Isroli

2023

Voster Jhal

ED. PALOKA

Bujar Leskaj

~~Signature~~

Tona Zhupa

Petrit Vardi

Novibe Sayemodli

ISHKIPARIA.COM